



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 5 , datë 01.02.2019

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR MIRATIMIN
E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS KANALIZIME VORË

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi i KKRR nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi i KKRR nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 01.02.2019 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e Ujësjetës Kanalizime Vorë sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

Konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjetës Kanalizime Vorë (UK Vorë) është licencuar me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 44, datë 14.10.2016, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Vorë" (**Vendimi i KKRR nr. 44**) pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (**VKM nr. 63**).
- Shoqëria Ujësjetës Kanalizime Vorë ka aplikuar për herë të parë pranë ERRU me shkresën nr. 577 prot. datë 26.06.2018, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura", për miratimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

- Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Vorë kishte pasaktësi sa i takon Seancës Dëgjimore me Publikun, pasi kjo e fundit nuk ishte zhvilluar konform udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore ku të jenë prezent edhe përfaqësuesit e ERRU.
- ERRU ju drejtua shoqërisë me shkresën nr. 328/1 prot, datë 23.07.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm. Shoqëria UK Vorë me shkresë nr. 1192 prot, datë 07.12.2018 ka njoftuar ERRU-në për zhvillimin e Seancës Dëgjimore me Publikun me datë 17.12.2018 pranë ambienteve të Bashkisë Vorë dhe me shkresë nr. 40 prot, datë 11.01.2019 ka dërguar proces verbalin e zhvillimit të saj.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vorë për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Vorë sh.a. dhe Bashkinë Vorë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.